

Emri i Lëndës : Editim Audio dhe Video							
Kodi	Tipi	Semestri	Leksione (orë/javë)	Seminare (orë/javë)	Lab (orë/javë)	Kredite	ECTS
MUL 204	B	Pranverë	2.00	0.00	0.00	1.50	3.00
Lektori		Alban Tufa, Msc					
Asistenti							
Gjuha e kursit		Shqip					
Niveli i lëndës		Program Profesional 2-Vjeçar					
Përshkrimi		Në këtë lëndë flitet mbi konceptet teknike të punës në ekip apo të individualizuar për realizimin e produkteve audio dhe video, editimin i audios dhe i videos për mediat tradicionale audio vizuale, apo i përshtatur për mediat sociale, ka rëndësi jetike për mesazhet që ata përçojnë tek publiku. Nëpërmjet kësaj disipline, studentët do të aftësohen me njohuri mbi rolin dhe teknikat e editimit me qëllim përfitimin e materialeve të vlefshme për transmetim.					
Objektivat							
Konceptet Kryesore		1. Editim audio 2. Editim video 3. Kalime 4. Sekuenca 5. Audio efekte 6. Video efekte					
Programi i Lëndës							
Java	Tema						
1	Hyrje. Prezantimi i lëndës Në këtë leksion bëhet një hyrje e kursit. Hyrja përmban shpjegimin e objektivave të lëndës, përshkrimin e saj, si dhe shpjegimin e detajuar të temave të cilat do të zhvillohen javë pas jave. Po ashtu, gjatë këtij leksioni, studentët njihen me zërat e vlerësimit të lëndës, si dhe me projektet që do të kryhen gjatë semestrit për lëndën e Editimit të audios dhe të videos.						
2	Njohja me programet e editimit. Importimi dhe vendosja e materialeve në timeline. Mjetet e punës Përgjatë këtij leksioni studentët njihen me programet e editimit të tilla si Adobe Audition; Adobe Premiere Pro; After Effects dhe Filmora. Më tej, studentët njihen me parimet e editimit në këto programe, struktura e tyre, mjetet punës në këto programe, si dhe për mënyrën e importimit të materialeve në këto programe. Po ashtu, studentët për gjatë këtij leksioni, njihen dhe punojnë më vendosjen e materialeve në timeline (ose panelin e editimit) dhe specifikat e punës në të. Leksione të përgatitura nga lektori i lëndës						
3	Krijimi dhe editimi i tekstit; Në këtë leksion të kushtuar tekstit në programet e editimit, do të trajtohen mënyrat e vendosjes së grafikeve tekstuale, llojet e tekstit, specifikat që duhen pasur parasysh kur punojmë me tekstit. Po ashtu në këtë leksion do të trajtohen strishat dhe llojet e tyre, grafikat e gatshme si dhe grafikat e krijuara. Po ashtu në këtë leksion do të trajtohet titrimi dhe grafikat tekstuale për film; animimi i tekstit dhe efektet që mund të marrë. Leksioni bazohet kryesisht në editimin e tekstit ne Adobe Premiere Pro dhe Adobe After Effects. Leksione të përgatitura nga lektori i lëndës						
4	Regjistrimi dhe editimi i zërit në formën wave; Përgjatë këtij leksioni do të punohen me editimin e të dhënave audio. Punimi do të bëhen në formë EAVE. Në këtë leksion do të trajtohen llojet e zërit mono dhe zërit stereo; konvertimi në secilin lloj, prerja dhe fshirja e pjesëve të zërit; ngjitja e pjesëve të zërit, aplikimi i efekteve të ndryshme; reduktimi i zhurmave, rritja dhe ulja volumit të zërit, etj. Leksioni bazohet kryesisht në editimin e zërit në Adobe Audition. Leksione të përgatitura nga lektori i lëndës						
5	Editimi i zërit në Multitrack: editimet për podcast; Në këtë leksion do të trajtohet edhe punohen zëri në formën Multitrack (me shumë zëra). Përgjatë leksioni do të trajtohen editimi dhe miksimi i zërave; vendosja dhe mbivendosja e efekteve zanore; rrëfimet audio, si dhe editimi i zërit posaçërisht për podkaste. Leksioni bazohet kryesisht në editimin e zërit në Adobe Audition. Leksione të përgatitura nga lektori i lëndës						

6	Editimi video me bazë audio: Sinkronizimi i zërit me videon; Në këtë leksion trajtohen karakteristikat e audios për video; roli dhe domosdoshmëria e ndërfaqeve për regjistrim, regjistrimi, importimi, volumi, ritmi, prerja, mbivendosja, efektet. Po ashtu trajtohen edhe sinkronia mes audios dhe videos, modelet e montimit, efektet paralele, dhe eksportimi i videos. Leksioni bazohet kryesisht në editimin e tekstit ne Adobe Premiere Pro. Leksione të përgatitura nga lektori i lëndës
7	Editimi audio dhe video: aplikimi dhe rëndësia e imazheve kyçe (key frame) dhe efektet e kontrolluara; Në këtë leksion trajtohen karakteristikat e audios për video; roli dhe domosdoshmëria e ndërfaqeve për regjistrim, regjistrimi, importimi, volumi, ritmi, mbivendosja e sekuecave. Më tej diskutohet dhe praktikohen pikëzimet (key frame) si dhe roli që kanë në animin e imazheve dhe aplikimin e tyre. Po ashtu trajtohen edhe sinkronia mes audios dhe videos, si dhe efektet paralele. Leksioni bazohet kryesisht në editimin e tekstit ne Adobe Premiere Pro Leksione të përgatitura nga lektori i lëndës
8	Provimi gjysmë final
9	Editimi audio dhe video: prerja, ngjitja dhe streçimi i sekuecave; Përgjatë këtij leksioni do të punohen me editimin e të dhënave video duke ndërhyrë në to nëpërmjet prerjes, çfarë duhet të kemi parasysh kur presim sekuecat video, si i ndërtojme kuptimet dhe emocionet nëpërmjet prerjes; çfarë duhet të ndodh me audion kur presim sekuecat video. Po ashtu në leksion trajtohen ngjitja ose bashkimi i imazheve, si dhe streçimi i tyre. Leksioni bazohet kryesisht në editimin e tekstit ne Adobe Premiere Pro. Leksione të përgatitura nga lektori i lëndës
10	Editimi i audio dhe video tranzicioneve; Ky leksion analizon dhe praktikon mënyrat e kalimit nga sekuenca në sekuecë qofshin këto sekuenca audio apo sekuenca video; aplikimin e efektëve vizuale dhe efektëve zanore. Po ashtu leksioni trajton dy llojet kryesore: efektet e paracaktuara dhe efektet mbi të cilat ne kemi kontroll të plotë, pra efektet të krijuara nga edituesi. Leksioni bazohet kryesisht në editimin e tekstit ne Adobe Premiere Pro. Leksione të përgatitura nga lektori i lëndës
11	Aplikimi i video dhe audio efektëve; Ky leksion analizon dhe praktikon mënyrat e aplikimit të efektëve. Cilësimi ngjyave dhe efektëve të tjera të aplikueshme në sekuecat video; prerja e kornizave, sfumimi i imazheve, stabilizimi i tyre, etj. Po ashtu leksioni trajton edhe aplikimin e efektëve në sekuecat audio. Leksioni bazohet kryesisht në editimin e tekstit ne Adobe Premiere Pro dhe Adobe Audition. Leksione të përgatitura nga lektori i lëndës
12	Zëvendësimi i sfondeve (green screen) dhe efektet mbi objekte; Ky leksion analizon dhe praktikon mënyrat e zëvendësimit të imazheve dhe objekteve nëpërmjet metodës Croma Key. Nëpërmjet ushtrimeve të ndryshme në këtë leksion aplikohet zëvendësimi të imazheve dhe objekteve në sekuecat video. Leksioni bazohet kryesisht në editimin e tekstit ne Adobe Premiere Pro Leksione të përgatitura nga lektori i lëndës
13	Editimi për platformat Në këtë leksion do të trajtohen aspektet teorike të montimit të tilla si planet, detajet, teknikat e editimit të filmit, kronikës dhe reklamës, llojet e ndryshme të prerjes, teknikat e regjistrimeve të efektëve zanore, lëvizjet e ngadalta dhe lëvizjet e shpejta të imazheve. Leksione të përgatitura nga lektori i lëndës
14	Eksportimi dhe formatet e ruajtjes së videos dhe audios; Në këtë leksion do të trajtohet finalizimi i punës së edituar duke bërë ruajtjen dhe eksportimin e saj. Po ashtu në këtë leksion do të trajtohen llojet dhe formatet e ruajtjes së audios dhe të videos, për platforma të ndryshme në programet editimit (Adobe Audition; Adobe Premiere Pro; After Effects dhe Filmora), lidhjet dinamike mes sistemit multimedial Adobe Creative Cloud, si dhe eksportimi nëpërmjet Adobe Media Encoder. Leksione të përgatitura nga lektori i lëndës
15	Prezantim projektesh; Në këtë javë të parafundit studentët prezantojnë projektet semestrale në laborator, si dhe diskutohen rreth tyre në mënyrë kritike.
16	Final Exam

Parakushtet	Studenti duhet të frekuentojë lëndën në masën minimale prej 75%.		
Literatura	• “The Technique of Film and Video Editing: History, Theory, and Practice”, Ken Dancyger, Sixth Edition, Routledge, Lodon 2019 • “Film and Video Editing Theory: How Editing Creates Meaning”, Michael Frierson, Routledge, Lodon 2018.		
Referenca të tjera	• “Classroom in a book: The official training workbook from Adobe Systems”, Maxim Jago, Adobe Press 2019 • Samuel J. Sauls, Craig A. Stark (2018): Audio production, worktext. Concepts, techniques, equipment, Focal Press book, Ninth edition, Routledge, Lodon.		
Rezultatet e Lëndës dhe Kompetencat			
1	Studenti merr njohur mbi rolin e proceseve edituese.		
2	Studenti aftësohet mbi editimin e audios dhe rëndësinë e tij në transmetim.		
3	Në fund të ciklit të leksioneve studenti është aftësuar mbi editimin e videove.		
4	Një pikë e fortë është edhe aftësimi i editmit në platformat moderne digjitale		
5	Studenti mëson rreth situatave dhe kushteve të transmetimeve radiotelevizive dhe online.		
6	Studenti përfiton zotësi në njohjen gjuhës teknike dhe përdorimin e saj.		
Mënyra e Vlerësimit të Lëndës			
Notat e Ndërmjetme		Sasia	Përqindja
Gjysmë finale		1	40
Kuize		0	0
Projekte		0	0
Projekte semestrale		0	0
Punë laborator		1	10
Pjesëmarrja në mësim		0	0
Kontributi i notave të ndërmjetme mbi vlerësimin final			50
Kontributi i provimit final mbi vlerësimin final			50
Total			100
Ngarkesa ECTS (Në Bazë të Ngarkesës së Studentit)			
Aktivitetet	Sasia	Kohëzgjatja (orë)	Ngarkesa Totale (orë)
Kohëzgjatja e kursit (Duke përfshirë edhe javën e provimeve : 16x Orët totale të kursit)	16	2	32
Orët e studimit jashtë klase (Parapërgatitje, Praktika etj)	14	3	42
Detyra	0	0	0
Gjysmë finale	1	0	0
Provimi final	1	1	1
Të tjera	0	0	0
Ngarkesa totale e orëve			75
Ngarkesa totale e orëve / 25 (orë)			3.00
ECTS			3.00